



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 138

Tiranë – E hënë, 3 gusht 2015

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 22.7.2015	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.3.2015, për çështjen “Siliqi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (aplikimet nr.37295/05 dhe nr.42228/05).....	9831
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 22.7.2015	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 24.3.2015, për çështjen “Lako kundër Shqipërisë” dhe 7 aplikime të tjera (aplikimet nr. 45718/12, nr. 9403/13, nr. 11724/13, nr. 11726/13, nr. 38964/13, nr. 6037/14, nr. 17174/14, nr. 48723/14).....	9831
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 22.7.2015	Për indeksimin e pensioneve.....	9833
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 22.7.2015	Për indeksimin e masës së shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar.....	9836
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 653, datë 22.7.2015	Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.....	9837
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 654, datë 22.7.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për disa institucione publike, për financimin e shpenzimeve për pajisjen me kaldaja me lëndë djegëse pelet.....	9839
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 655, datë 22.7.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Robert Shvarc” e Rrugës së Kosovarëve, si dhe rikualifikimi urban i bllokut nr. 46, të Bashkisë së Tiranës.....	9840

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 22.7.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tribunës kryesore në perëndim dhe në jug, rikonstruksioni i tribunës ekzistuese në veri dhe në lindje, si dhe infrastrukturës përreth Stadiumit “Loro Boriçi”, Shkodër” .....	9841
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 29.7.2015	Për ngarkimin e ministrisë së zhvillimit urban për kryerjen e procedurave të prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e planeve të përgjithshme vendore deri për 26 bashki.....	9842
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 20, datë 30.7.2015	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 5, datë 19.1.2009 "Për procedurat e hapjes dhe mbylljes së sallave të lojërave, basteve sportive, kazinove elektronike, bingove tradicionale".....	9843
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 57, datë 13.7.2015	Plani i ndihmës shtetërore “Për krijimin e skemës “Voucher”.....	9843
Vendim i Komisionit të Ndihmës nr. 58, datë 13.7.2015	Skema e ndihmës shtetërore për realizimin e investimeve strategjike.....	9845

**VENDIM****Nr. 649, datë 22.7.2015**

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË  
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË  
DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.3.2015,  
PËR ÇËSHTJEN “SILIQI DHE TË  
TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”  
(APLIKIMET NR.37295/05 DHE  
NR.42228/05)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.3.2015, për çështjen “Siliqi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (aplikimet nr. 37295/05 dhe nr. 42228/05), në shumën 1 498 400 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind) euro, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të aplikantëve në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.3.2015, për çështjen “Siliqi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (aplikimet nr. 37295/05 dhe nr. 42228/05).

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të aplikantëve, znj. Drita Siliqi (Shundi), znj. Mariana Shundi, z. Andrea Shundi dhe znj. Gjenovefa Mihali (Shundi), të bëhet nga Ministria e Financave pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të

nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit tremujor të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumën e sipërpërmendura paguhen interesa të thjeshtë, të barabartë me kursin marzhinal të huasë së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës të buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 650, datë 22.7.2015**

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË  
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË  
DREJTAT E NJERIUT, DATË 24.3.2015,  
PËR ÇËSHTJEN “LAKO KUNDËR  
SHQIPËRISË” DHE 7 APLIKIME TË  
TJERA (APLIKIMET NR. 45718/12, NR.  
9403/13, NR. 11724/13, NR. 11726/13, NR.  
38964/13, NR. 6037/14, NR. 17174/14, NR.  
48723/14)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 24.3.2015, për çështjen “Lako kundër Shqipërisë” dhe 7 aplikime të tjera: nr. 45718/12



(Lako); nr. 9403/13 (Paluka); nr. 11724/13 (Taba); nr. 11726/13 (Karanxha); nr. 38964/13 (Trupja); nr. 6037/14 (Osmani); nr. 17174/14 (Verdhi) dhe nr. 48723/14 (Luku), për sa u përket shumave të përcaktuara sipas shtojcës 2 dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave vendase sipas shtojcës 3, bashkëlidhur këtij vendimi, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të aplikantëve sipas listës së aplikantëve në shtojcën 2 bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 24.3.2015, për çështjen “Lako kundër Shqipërisë” dhe 7 aplikime të tjera.

4. Pagimi i shumave të depozituara sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të aplikimeve nr. 45718/12 (Lako); nr. 9403/13 (Paluka); nr. 11724/13 (Taba); nr. 11726/13 (Karanxha); nr. 38964/13 (Trupja); nr. 6037/14 (Osmani); nr. 17174/14 (Verdhi) dhe nr. 48723/14 (Luku) të bëhet nga Ministria e Financave pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda një afati 3-mujor nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 24.3.2015, është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit tremujor të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e sipërpërmendura paguhen interesa të thjeshtë, të barabartë me kursin marzhinal të huasë së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve Durrës, që, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 24.3.2015, është bërë përfundimtar të ekzekutojnë në favor të aplikantëve vendimet përfundimtare të gjykatave vendase për rikthimin e aplikantëve në pozicionet e mëparshme, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës.

8. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

#### Shtojca 1 – Lista e aplikantëve

Nr.	Emri dhe numri i aplikimit	Emri i aplikantit (viti i lindjes)	Shteti i vendbanimit	Përfaqësuar nga	Data e prezantimit
1.	Lako nr. 45718/12	Elvin Lako (1976)	Shqipëri		27 qershor 2012
2.	Paluka, nr. 9403/13	Valbona Paluka (1964)	Shqipëri		09 janar 2013
3.	Taba, nr. 11724/13	Spiro Taba (1955)	Shqipëri		31 janar 2013
4.	Karanxha, nr. 11726/13	Andrea Karanxha (1956)	Shqipëri		01 shkurt 2013
5.	Trupja, nr. 38964/13	Raimonda Trupja (1968)	Shqipëri		25 maj 2013
6.	Osmani, nr. 6037/14	Indrit Osmani (1983)	Shqipëri		11 janar 2014
7.	Verdhi, nr. 17174/14	Thanas Verdhi (1946)	Shqipëri		19 shkurt 2014
8.	Luku, nr. 48723/14	Nazmi Luku (1952)	Shqipëri	Erind Mërkuri	23 qershor 2014

#### Shtojca 2 – Dëmi monetar, jomonetar dhe kosto e shpenzime

Nr.	Emri dhe nr. i aplikimit	Dëmi monetar dhe jo monetar
1.	Lako nr. 45718/12	3,300 euro (tre mijë e treqind euro)
2.	Paluka, nr. 9403/13	1,700 euro (një mijë e shtatëqind euro)
3.	Taba, nr. 11724/13	2,000 euro (dy mijë euro)
4.	Karanxha, nr. 11726/13	1,400 euro (një mijë e katërqind euro)



5.	<i>Trupja, nr. 38964/13</i>	4,700 euro ( <i>katër mijë e shtatëqind euro</i> ).
6.	<i>Osmani, nr. 6037/14</i>	6,300 euro ( <i>gjashtë mijë e treqind euro</i> ).
7.	<i>Verdhi, nr. 17174/14</i>	10,500 euro ( <i>dhjetë mijë e pesëqind euro</i> ).
8.	<i>Luku, nr. 48723/14</i>	2,000 euro ( <i>dy mijë euro</i> ).

**Shtojca 3 – Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare të gjykatave vendase**

No.	Emri dhe nr. i aplikimit	Institucioni përkatës	Vendimi përfundimtar
1.	<i>Lako nr. 45718/12</i>	Kryeministria	Vendim i KSHC nr. 266, datë 27.04.2006, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. 297, datë 14.12.2006 dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendim nr. 00-2008-236, datë 15.02.2008.
2.	<i>Paluka, nr. 9403/13</i>	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Vendim i KSHC nr. 127, datë 25.11.2010, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. 23, datë 01.03.2011 dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendim nr. 00-2011-986, datë 23.06.2011.
3.	<i>Taba, nr. 11724/13</i>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr. 1827, datë 07.07.2008, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendim nr. 345, datë 03.12.2008.
4.	<i>Karanzha, nr. 11726/13</i>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr. 167, datë 19.01.2009, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendim nr. 133, datë 27.04.2009.
5.	<i>Trupja, nr. 38964/13</i>	Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve Durrës	Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. 2918, datë 12.12.2006, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendim nr. 540, datë 03.12.2007.
6.	<i>Luku, nr. 48723/14</i>	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Vendim i KSHC nr. 38, datë 06.02.2008, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. 81, datë 18.06.2008 dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendim nr. 862, datë 09.07.2010.

**VENDIM  
Nr. 651, datë 22.7.2015**

**PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Indeksimin, në masën 1.4 për qind, të:

a) pensioneve të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”; nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën

Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuara;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

d) shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;



dh)shesave mbi pension, të dhëna sipas neneve 38, 39 dhe 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 24, të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

e) pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar;

f) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruar të nëndetësive dhe polumbarëve të forcave detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar,

gj) pensioneve të pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

h) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;

i) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së

Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”;

j) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar.

2. Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet të cilat caktohen nga data 1.8.2015 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.7.2015, përfshirë edhe këtë datë.

3. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, datë 6.11.2014, që kanë datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës 1.8.2015 nuk do të jenë më pak se 12 436 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në muaj dhe më shumë se 24 872 (njëzet e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë në muaj.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 31.12.2014 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 8 516 (tetë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë në muaj, por jo më shumë se 12 436 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

5. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.8.2015 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 12 436 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve dhe të të ardhurave, të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”; nr. 4976,



datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”; nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nr. 150/2014, datë 6.11.2014, me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshi edhe këtë datë, edhe pas indeksimit të pensionit të caktuar sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e çmimeve dhe kompensimin e të ardhurave mujore, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”; nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”; nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”.

7. Përfituesit e pensioneve të parakohshme sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.7.2015 përfshi edhe këtë datë, edhe pas indeksimit të pensionit të caktuar sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e çmimeve dhe kompensimin e të ardhurave mujore, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”; nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”; nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave

mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”.

8. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione me datë fillimi deri më 31.12.2014, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, pas indeksimit të pensioneve sipas pikës 1, të këtij vendimi, të jetë:

a) deri në 14 086 (katërbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe ato të caktuara me ligjin nr. 150/2014, datë 6.11.2014;

b) deri në 13 586 (trembëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

c) deri në 9 206 (nëntë mijë e dyqind e gjashtë) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, me datë fillimi deri më 31.7.2015 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 14 086 (katërbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.



10. Pas datës 1.8.2015 të ardhurat minimale:

a) të personave që përfitojnë pensionet e plota të pleqërisë (përfshirë edhe ato të caktuara me ligjin nr. 150/2014, datë 6.11.2014), përjashtuar ato të caktuara sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe kompensime vetjake, me datë fillimi deri më 31.12.2014, nuk mund të jenë më të ulëta se 14 586 (katërbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj;

b) të personave që përfitojnë nga pensionet e caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe kompensime për çmimin e energjisë elektrike e për të ardhurat, nuk mund të jenë më të ulëta se 9 406 (nëntë mijë e katërqind e gjashtë) lekë në muaj dhe më të larta se 12 636 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në muaj;

c) të personave, që përfitojnë pensione të parakohshme për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, dhe kompensime vetjake, nuk mund të jenë më të ulëta se 14 586 (katërbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

11. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 568 000 000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë) lekë, përballohen nga fondi i kontingjencës, i parashikuar në buxhetin e shtetit të vitit 2015 dhe ndahen përkatësisht:

a) 554 000 000 (pesëqind e pesëdhjetë e katër milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të pensioneve;

b) 14 000 000 (katërbëdhjetë milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare, sh.a.

12. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për të nxjerrë udhëzues teknikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2015.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

## VENDIM

Nr. 652, datë 22.7.2015

### PËR INDEKSIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Indeksimin në masën 15.6 për qind të shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i përcaktuar në vendimin nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar”, duke arritur vlerat e mëposhtme:

a) Shpërblimi sipas shkronjës “a”, të pikës 7, nga 3 383 lekë bëhet 3 911 lekë në muaj.

b) Shpërblimi sipas shkronjës “b”, të pikës 7, nga 2 709 lekë bëhet 3 132 lekë në muaj.

c) Shpërblimi sipas shkronjës “c”, të pikës 7, nga 2 255 lekë bëhet 2 607 lekë në muaj.

ç) Shpërblimi sipas shkronjës “e”, të pikës 7, nga 676 lekë bëhet 781 lekë në muaj.

d) Shpërblimi sipas pikës 8/1 (për kohën e vuajtjes në burg mbi 6 muaj), nga 1 127 lekë bëhet 1 303 lekë në muaj.

dh) Shpërblimi sipas pikës 8/2 (për kohën e vuajtjes në burg nga 1 deri në 6 muaj), nga 678 lekë bëhet 784 lekë në muaj.

e) Shpërblimi sipas shkronjës “a”, të pikës 9, nga 3 383 lekë bëhet 3 911 lekë në muaj.





ë) Shpërblimi sipas shkronjës “b”, të pikës 9, nga 2 255 lekë bëhet 2 607 lekë në muaj.

f) Shpërblimi sipas pikës 11 nga 1 127 lekë bëhet 1 303 lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përllogariten në shumën 16 600 mijë lekë dhe përballohen nga fondi i kontingjencës, të parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2015.

3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të nxjerrë udhëzimet përkatëse teknike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2015.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**VENDIM**  
**Nr. 653, datë 22.7.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË  
VENDIMIN NR. 77, DATË 28.1.2015, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
KONTRIBUTET E DETYRUESHME  
DHE PËRFITIMET NGA SISTEMI I  
SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE  
SIGURIMI I KUJDESIT  
SHËNDETËSOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve

të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve të nëntokës”, dhe të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun III, “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve”, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 13, 14 e 16 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“13. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 4 696 (katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, nga të cilat 3 200 (tre mijë e dyqind) lekë për sigurime shoqërore dhe 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

14. Për personat që punojnë si punëtorë shtëpie, punëdhënësi të deklarojë dhe të paguajë kontribut minimal mujor në shumën 3 948 (tre mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekë, nga të cilat 3 200 (tre mijë e dyqind) lekë për sigurime shoqërore dhe 748 (shtatëqind e dyzet e tetë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

...

16. Të vetëpunësuarit në bujqësi të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore në masën 38 400 (tridhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 29 400 (njëzet e nëntë mijë e katërqind) lekë.”

b) Shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 18, ndryshohen, si më poshtë vijon:



“a) Personat që kryejnë funksione kushtetuese, punonjësit e lartë të shtetit, sipas funksioneve, në masën 4, 3 dhe 2 % të pagës bruto, nga data 1.1.2015 e deri në datën 30.4.2015, dhe në masën 5, 4 dhe 3% të pagës bruto, nga data 1.5.2015 e në vazhdim.

...

c) Personat që kanë titullin shkencor “Profesor”, “Drejtues kërkimesh”, “Profesor i asociuar”, “Mjeshtër kërkimesh”, kur punojnë në universitetet, shkollat e larta dhe Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, në masën e përcaktuar në nenin 4, “Masa e kontributeve”, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, nga data 1.1.2015 dhe në vazhdim.”

Pika 21 ndryshohet, si më poshtë vijon:

c) “21. Për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë dhe gratë që dalin në pension, për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, buxheti i shtetit derdh kontribute për degën e pensioneve në masën 21.6% të pagës minimale. Për personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, duke filluar nga data 1.1.2015 e në vazhdim, buxheti i shtetit derdh kontribute edhe për degën e barrë lindjeve dhe aksidenteve në punë në masën 1.7 % të pagës minimale.”

2. Në kreun VIII, “Shuma bazë e përfitimeve”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Shuma bazë mujore e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për personat që plotësojnë kushtet për përfitim sipas dispozitave të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të

Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nga data 1.8.2015 e në vazhdim, të jetë 12 436 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

Përfituesit e pensionit të parakohshëm kanë të drejtën e kompensimit të çmimeve sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 138, datë 31.3.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”.

Përfituesit e pensionit të parakohshëm minimal kanë të drejtën edhe të kompensimit të të ardhurave, sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajurit dhe gazit të lëngshëm”; nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë 14 086 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj. Në rastet kur pensioni për vjetërsi shërbimi rezulton më i lartë se pensioni bazë dhe, bashkë me kompensimet e të ardhurave, rezulton më i lartë se shuma e të ardhurave minimale prej 14 086 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh, kompensimet jepen pjesore, deri në plotësimin e kësaj shume.

...

5. E ardhura për barrë lindje për gratë të cilat periudhën e sigurimit për efekt të përfitimit të barrë lindjes e kanë kanë si persona të vetëpunësuar në bujqësi ose kanë më shumë se 6 muaj të periudhës së fundit të sigurimit nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, si persona të vetëpunësuar në bujqësi, duke filluar nga data 1.8.2015, e në vazhdim, do të jetë 8 516 (tetë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë në muaj.”

b) Pas pikës 6 shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Për zbatim të paragrafit të dytë të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe



rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, pensioni mesatar është sa 1,5-fishi i pensionit bazë të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi. Kur personi që përfiton nga nenin 1, i ligjit të sipërshtetësuar nuk plotëson periudhën e sigurimit sipas përcaktimeve në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mund të zgjedhë të marrë pension të pjesshëm mesatar, shuma e të cilit përlogarit duke shumëzuar pensionin mesatar me raportin midis periudhës faktike të sigurimit me periudhën e përcaktuar në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, për vitin përkatës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.8.2015.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**VENDIM**  
Nr. 654, datë 22.7.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR  
PËR DISA INSTITUCIONE PUBLIKE,  
PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE  
PËR PAJISJEN ME KALDAJA ME LËNDË  
DJEGËSE PELET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2015, ministrive të poshtëshënuara t’u jepet shtesë fondi, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Shëndetësisë t’i shtohet fondi prej 55 262 424 (pesëdhjetë e pesë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e njëzet e katër) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për blerjen dhe vendosjen e 31 (tridhjetë e një) kaldajave me lëndë djegëse pelet.

b) Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë t’i shtohet fondi prej 1 396 080 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për blerjen dhe vendosjen e 1 (një) kaldaje me lëndë djegëse pelet.

c) Ministrisë së Arsimit dhe Sportit t’i shtohet fondi prej 1 396 080 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë) lekësh, për blerjen dhe vendosjen e 1 (një) kaldaje me lëndë djegëse pelet.

ç) Ministrisë së Punëve të Brendshme t’i shtohet fondi prej 38 579 688 (tridhjetë e tetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh, për blerjen dhe vendosjen e 38 (tridhjetë e tetë) kaldajave me lëndë djegëse pelet.

d) Ministrisë së Drejtësisë t’i shtohet fondi prej 37 764 048 (tridhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyzet e tetë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për blerjen dhe vendosjen e 26 (njëzet e gjashtë) kaldajave me lëndë djegëse pelet.

dh) Ministrisë së Kulturës t’i shtohet fondi prej 11 773 944 (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për blerjen dhe vendosjen e 8 (tetë) kaldajave me lëndë djegëse pelet.

2. Efekti financiar, prej 146 172 264 (njëqind e dyzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh, i parashikuar në shkronjat “a” – “dh”, të pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama



## VENDIM

Nr. 655, datë 22.7.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS "ROBERT SHVARC" E RRUGËS SË KOSOVARËVE, SI DHE RIKUALIFIKIMI URBAN I BLOKUT NR. 46, TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës "Robert Shvarc" e i Rrugës së Kosovareve, si dhe rikualifikimi urban i bllokut nr. 46, të Bashkisë së Tiranës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, sipas vlerave të mëposhtme:

a) Për ndërtimin e rrugës "Robert Shvarc", me sipërfaqe prej 42 (dyzet e dy) m<sup>2</sup> "truall", në vlerën 944 706 (nëntëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë.

b) Për ndërtimin e Rrugës së Kosovareve, me sipërfaqe prej 1 460 (një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) m<sup>2</sup> "truall", në vlerën 83 403 960 (tetëdhjetë e tre milionë e katërqind e tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

c) Për rikualifikimin urban të bllokut nr. 46 të qytetit, me sipërfaqe prej 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) m<sup>2</sup> "truall", në vlerën 6 683 742 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzet e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 91 032 408 (nëntëdhjetë e një milionë e tridhjetë e dy mijë e katërqind e tetë) lekësh të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë (3) tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Tiranës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 1 619 (një mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) m<sup>2</sup> "truall" për ndërtimin e rrugës "Robert Shvarc", Rrugës së Kosovareve, si dhe rikualifikimin urban të bllokut nr. 46 të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

## 1. Lista e personave dhe pronave që do të shpronësohen për ndërtimin e rrugës së "Kosovarëve", Bashkia Tiranë

Nr	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërf. përgj./ m <sup>2</sup>	Sip. Tr. të prekur / m <sup>2</sup>	Çmimi truallit/lekë	Vlera në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Hedie Hasan Bashaj	8270	6/432	237.3	198	57,126	11,310,948	Konf.shkr.nr.21468/1, dt.02.12.14
2	Bashkpr.Brari, Deliu, Lusha, Baftjari dhe Garunja.	8270	6/289	1180	830	57,126	47,414,580	Konf.shkr.nr.21468/1, dt.02.12.14
3	Pëllumb, Myzafer Shuka	8270	6/287	400	232	57,126	13,253,232	Konf.shkr.nr.21468/1, dt.02.12.14
4	Bashkpronarët Jani	8270	6/176	318,1	200.0	57,126	11,425,200	Konf.shkr.nr.21468/1, dt.02.12.14
	<b>Totali</b>				<b>1 460</b>		<b>83 403 960</b>	

## 2. Lista e personave dhe pronave që do të shpronësohen për rikualifikimin urban të bllokut nr.46, Bashkia Tiranë

Nr	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërf. Përgj./ m <sup>2</sup>	Sip. Tr. të prekur / m <sup>2</sup>	Çmimi në lekë	Vlefata në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Bashkpronarët Kamza	8350	2/472	117	117	57,126	6,683,742	Konf.shkr.nr.prot.5842/1,dt.03.04.13
	<b>Totali</b>				<b>117 m<sup>2</sup></b>		<b>6 683 742</b>	



## 3. Lista e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të rikonstruksionit të rrugës "Robert Shvac", Bashkia Tiranë

Nr	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Truall/m <sup>2</sup>	Çmimi/m <sup>2</sup>	Vlefë në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Mustafa Gjata	8260	6/324	30	22493	674,790	Konf.shkr.nr.prot.18812/1, dt.13.12.12
2	Shpresa Dervishi me 2 bashkpr.	8260	6/271	12	22493	269,916	Konf.shkr.nr.prot.18812/1, dt.13.12.12
	<b>Totali</b>			<b>42</b>		<b>944 706</b>	

**VENDIM****Nr. 656, datë 22.7.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I TRIBUNËS KRYESORE NË PERËNDIM DHE NË JUG, RIKONSTRUKSIONI I TRIBUNËS EKZISTUESE NË VERI DHE NË LINDJE, SI DHE INFRASTRUKTURËS PËRRETH STADIUMIT "LORO BORIÇI", SHKODËR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Ndërtimi i tribunës kryesore në Perëndim dhe në Jug, rikonstruksioni i tribunës ekzistuese në Veri dhe në Lindje, si dhe infrastrukturës përreth stadiumit 'Loro Boriçi', Shkodër".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe trualli dhe ndërtimore, me një vlerë të përgjithshme prej 37 617 626 (tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 37 617 626 (tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e

shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Shpronësimi të fillojë në datën 25.7.2015.

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Shkodër.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**



Lista e personave që do të shpronësohen për projektin me objekt : Ndërtimi i Tribunës kryesore në perëndim dhe në Jug, rikonstruksioni i Tribunës ekzistuese në Veri dhe në Lindje si dhe infrastrukturës përreth stadiumit " Loro Borici ", Bashkia Shkodër

Nr	Nr .pasurie	Z.kadastrale	Pronari / Emër e mbiemër	Sip. Truallit m <sup>2</sup>	Çmimi truallit lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Vlera e ndërtesës lekë	TOTALI lekë	Shënime
1	7/618	8591	Bashke Pronaret Vadahaj	273	8500	2,320,500		2,320,500	Konfirmuar nga ZRPP
2	7/692	8591	Shteti	138	8500	0		0	Konfirmuar nga ZRPP
3	7/815	8591	Sezai Shpuza	757	8500	6,434,500		6,434,500	Konfirmuar nga ZRPP
4	7/814	8591	Bardhyl Shpuza	110	8500	935,000		935,000	Konfirmuar nga ZRPP
5	7/656	8591	Bashke Pronaret Ceka,Kali,Mandija	220	8500	1,870,000		1,870,000	Konfirmuar nga ZRPP
6	7/654	8591	Shteti	2263	8500	0		0	Konfirmuar nga ZRPP
7	7/374	8591	Fiqiri Rexha	44	8500	374,000		374,000	Konfirmuar nga ZRPP
8	6/281	8591	Shteti	230	8500	0		0	Konfirmuar nga ZRPP
9	6/461	8591	Pronar i pavërtetuar	98	8500	833,000		833,000	Konfirmuar nga ZRPP
10	6/406	8591	Pronar i pavërtetuar	286	8500	2,431,000		2,431,000	Konfirmuar nga ZRPP
11	6/490	8591	Myftinia Shkoder	95	8500	807,500		807,500	Konfirmuar nga ZRPP
12	6/429	8591	Astrit Dibra	94	8500	799,000		799,000	Konfirmuar nga ZRPP
13	6/422	8591	Ferid Bushati	18.5	8500	157,250		157,250	Konfirmuar nga ZRPP
14	6/280	8591	Shteti	666	8500	0		0	Konfirmuar nga ZRPP
15	7/606	8591	Shteti	650	8500	0		0	Konfirmuar nga ZRPP
16	7/256	8591	Bashkepronaret Bala	100	8500	850,000		850,000	Konfirmuar nga ZRPP
17	7/326	8591	Astrit Sokoli	28	8500	238,000		238,000	Konfirmuar nga ZRPP
18	7/327	8591	Astrit Sokoli	45	8500	382,500		382,500	Konfirmuar nga ZRPP
19	7/794	8591	Shteti	6327.5	8500	0		0	Konfirmuar nga ZRPP
20	7/739	8591	Skender Ferhati	13	8500	110,500	437,586	548,086	Konfirmuar nga ZRPP
21	7/740	8591	Lirim Plori	55	8500	467,500	2,368,290	2,835,790	Konfirmuar nga ZRPP
22	7/796	8591	Sokol Lici	37	8500	314,500		314,500	Konfirmuar nga ZRPP
23	7/835	8591	Lici-Shpk	200	8500	1,700,000		1,700,000	Konfirmuar nga ZRPP
24	7/638	8591	Bujar Kalaci, Ilirjan Kalaci	329	8500	2,796,500		2,796,500	Konfirmuar nga ZRPP
25	7/806	8591	Fatmir Talani, Arben Talani	25	8500	212,500		212,500	Konfirmuar nga ZRPP
26	7/799	8591	Bashkepronaret Dervishi	399	8500	3,391,500		3,391,500	Konfirmuar nga ZRPP
27	7/800	8591	Bashkia Shkoder	203	8500	0		0	Konfirmuar nga ZRPP
28	7/801	8591	Bashkepronaret Dervishi	74	8500	629,000		629,000	Konfirmuar nga ZRPP
29	7/802	8591	Bashkia Shkodër	214	8500	1,819,000		1,819,000	Konfirmuar nga ZRPP
30	7/580	8591	Pronar i pavërtetuar	290	8500	2,465,000		2,465,000	Konfirmuar nga ZRPP
31	7/619	8591	Fiqiri Vadahaj	291	8500	2,473,500		2,473,500	Konfirmuar nga ZRPP
32	7/743	8591	Myftinia Shkodër	84	8500	714,000		714,000	Konfirmuar nga ZRPP
			<b>TOTALI I SHPRONËSIMIT</b>	<b>14657</b>				<b>37,617,626</b>	

## VENDIM

Nr.670, datë 29.7.2015

### PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR REALIZIMIN E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT PËR HARTIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE DERI PËR 26 BASHKI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për kryerjen e procedurës së prokurimit për

realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e planeve të përgjithshme vendore deri për 26 bashki, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve, për vitin 2015, për realizimin e procedurave të prokurimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban për vitin 2015.

3. Pjesa tjetër e fondeve prej 530 000 000 (pesëqind e tridhjetë milionë) lekësh të përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2016. Kjo vlerë të parashikohet në buxhetin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për vitin 2016.

4. Ministria e Zhvillimit Urban të fillojë procedurat e prokurimit sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe, përpara lidhjes së kontratës për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e planeve, të marrë miratimin e njëjësive të qeverisjes vendore dhe të lidhë aktmarrëveshjen përkatëse. Lidhja e aktmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe bashkisë për caktimin e kushteve dhe të drejtave e të



detyrimeve midis palëve është kusht për lidhjen e kontratës për hartimin e planeve vendore nga kjo ministri.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe bashkitë, sipas listës bashkëlidhur vendimit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

LISTA E BASHKIVE

- |                |                   |
|----------------|-------------------|
| 1) Dibër       | 14) Konispol      |
| 2) Durrës      | 15) Krujë         |
| 3) Gjirokastrë | 16) Kurbin        |
| 4) Korçë       | 17) Librazhd      |
| 5) Kukës       | 18) Përrenjas     |
| 6) Lezhë       | 19) Pogradec      |
| 7) Shkodër     | 20) Poliçan       |
| 8) Tiranë      | 21) Rrogozhinë    |
| 9) Vlorë       | 22) Sarandë       |
| 10) Cërrik     | 23) Shijak        |
| 11) Divjakë    | 24) Skrapar       |
| 12) Himarë     | 25) Urë-vajgurore |
| 13) Kavajë     | 26) Vorë          |

UDHËZIM

Nr. 20, datë 30.7.2015

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN  
NR. 5, DATË 19.1.2009 "PËR  
PROCEDURAT E HAPJES DHE  
MBYLLJES SË SALLAVE TË LOJËRAVE,  
BASTEVE SPORTIVE, KAZINOVE  
ELEKTRONIKE, BINGOVE  
TRADICIONALE"**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10 pika 4, të ligjit nr. 10 033, datë 11.12.2008, "Për lojërat e fatit", të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 19.1.2009 "Për procedurat e hapjes dhe mbylljes së sallave të lojërave, basteve sportive, kazinove elektronike, bingove tradicionale" bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, pas shkronjës c.4, shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore".

2. Në pikën 2, pas shkronjës "c", shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE

Shkëlqim Cani

VENDIM

Nr. 57, datë 13.7.2015

**PLANI I NDIHMËS SHTETËRORE  
"PËR KRIJIMIN E SKEMËS "VOUCHER"**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtar
Dareka Dariu	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtar.

Në mbledhjen e tij të datës 13/07/2015, shqyrtoi raportin për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për krijimin e skemës "Voucher"". Njoftimi i skemës është bërë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETIS).

OBJEKTIVI I SKEMËS SË NDIHMËS: Skema synon të nxisë veprimtarinë e mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që operojnë në fushën e prodhimit, përfshirë agro-përpunimin, si dhe prodhimin e programeve kompjuterike (Software TIK), për t'i mundësuar atyre transferimin e drejtpërdrejtë të njohurive nga ofruesit e shërbimeve, për inovacione, teknikat e marketingut, duke ofruar përvoja dhe praktikat më të mira që nuk janë aplikuar më parë tek SME-të aplikuese dhe që do të ndikojnë në rritjen e konkurrencës dhe veprimtarisë ekonomike të tyre.

BAZA LIGJORE E SKEMËS: Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e skemës "Voucher"", me nismën e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,



## VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës janë mikrondërmarrjet, ndërmarrjet e vogla apo të mesme, të klasifikuara sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", të ndryshuar.

2. Ndihma do t'u jepet ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në fushën e prodhimit, përfshirë agro-përpunimin, si dhe prodhimin e programeve kompjuterike (Software TIK).

3. Ndihma do të jepet në formën e drejtpërdrejtë për mikrondërmarrjet, ndërmarrjet e vogla apo të mesme, nëpërmjet bashkëfinancimit. Në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar nga aplikanti/tët, skema mbulon 85% të kostove të pranueshme nga buxheti i shtetit dhe jo me shumë se 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

4. Kosto të pranueshme përfshijnë:

- Zhvillimin e produkteve të reja, përmirësimin e produkteve ekzistuese;

- Aplikimin e proceseve të reja teknologjike apo të përmirësuara të prodhimit;

- Përmirësimin e hallkave të logjistikës dhe sistemeve të marketingut;

- Zhvillimin e një modeli të ri biznesi ose strategji zhvillimi që premtion rritje të performancës;

- Testimin eksperimental.

5. Skema e njoftuar është parashikuar të zbatohet me fondet e buxhetit të shtetit, sipas parashikimeve të PBA për periudhën 2015-2017.

a) Për vitin 2015, vlera e fondit të jetë 1 000 000 (një milion) lekë.

b) Për vitin 2016, vlera e fondit të jetë 4 000 000 (katër milionë) lekë.

c) Për vitin 2017, vlera e fondit të jetë 4 000 000 (katër milionë) lekë.

6. Dhënës i ndihmës është Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHE/TTS), ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj mase do të jetë Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

7. Në kuptim të nenit 4 të ligjit "Për ndihmën shtetërore", skema e njoftuar përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- Ndihma jepet nga autoritete publike, përmes burimeve shtetërore/buxhetit të shtetit në kuptim

të nenit 4, pika 1 të ligjit nr.9374 datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore" të ndryshuar.

- Skema ka një efekt nxitës dhe është përzgjedhëse, sepse ndihma jepet për një numër të kufizuar ndërmarrjesh. Kriteret e përzgjedhjes parashikohet të përcaktohen në rregulloren e funksionimit të skemës "voucher", e cila do të miratohet me një urdhër të përbashkët nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ministri i Financave. Skemat "voucher" shërbejnë për të mbështetur SME-të, për të zhvilluar kapacitetet e tyre inovative, nëpërmjet sigurimit të një asistence teknike nga jashtë kompanisë. Përdorimi i skemës "voucher" është i nevojshëm për ndërmarrjet, duke qenë se kanë burime të kufizuara të kapaciteteve njerëzore dhe mjete financiare që nuk i mundësojnë të zhvillojnë know-how.

- Skema ka ndikim të papërfillshëm në tregti.

8. Skema e njoftuar është në përputhje me nenin 13, shkronja "c" "Ndihma shtetërore që mund të lejohet", duke qenë se lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

## PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 13, shkronja "c", 20, pika 1, 22, 30 dhe 31 të ligjit nr.9374, datë 21.04.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

## VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e njoftuar të ndihmës shtetërore "Për krijimin e skemës "Voucher"".

2. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

3. Të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Arben Ahmetaj





## VENDIM

Nr. 58, datë 13.7.2015

### SKEMA E NDIHMËS SHTETËRORE, PËR REALIZIMIN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtar
Dareka Dariu	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtar.

Në mbledhjen e tij të datës 13/07/2015, shqyrtoi skemën e ndihmës shtetërore për dhënien e lehtësive investitorëve në mbështetje të investimit strategjik, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të njoftuar me shkresën nr. 4917, datë 15.06.2015 nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si dhe vendosi të vlerësojë përputhshmërinë e kësaj skeme të ndihmës me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

#### I. PËRSHKRIMI I MASËS

a) Parashikimet kryesore të ligjit për investimet strategjike

1. Ligji nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” ka si qëllim nxitjen dhe mbështetjen e investimeve strategjike vendase dhe të huaja në sektorë dhe fushat e ekonomisë së vendit që paraqesin potencial të lartë zhvillimor. Ky ligj përcakton se investimet strategjike janë investimet private, publike ose publike-private në sektorët e energjisë dhe minierave, transportit, infrastrukturës dhe komunikimeve elektronike dhe mbetjeve urbane, turizmit, bujqësisë dhe peshkimit, zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, zonave me përparësi zhvillimi, si edhe nënsektorëve specifikë të cilët do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Nenin 27 “Përdorimi i pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e investimeve strategjike” parashikon që:

1. Në dispozicion të zhvillimit dhe realizimit të projekteve investuese strategjike, sipas këtij ligji, mund të vihen trojet, pyjet, tokat bujqësore, si dhe pasuritë e tjera të paluajtshme, në pronësi të shtetit shqiptar.

2. Mënyra e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Neni 31 “Fondi i pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike”, parashikon që:

1. Në funksion të mbështetjes shtetërore për realizimin e investimit, krijohet Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike, i cili krijohet nga pasuritë e paluajtshme shtetërore, në pronësi të institucioneve qendrore apo të njëjësive të qeverisjes vendore.

2. Mënyra e krijimit, funksionimit dhe administrimit të këtij fondi miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

b) Arsyet për vlerësimin e masës

4. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vëren se:

1. Vënia në dispozicion e trojeve, pyjeve, tokave bujqësore, si dhe të pasurive të tjera të paluajtshme, në pronësi të shtetit shqiptar për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, mund të përbëjë ndihmë shtetërore.

2. Krijimi i Fondit të Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike, me përbërje pasuritë e paluajtshme shtetërore në funksion të mbështetjes shtetërore për realizimin e investimit, aktivizon elementë të ndihmës shtetërore.

#### II. VLERËSIMI I MASËS

1. Ekzistenca e ndihmës shtetërore

5. Neni 4 i ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, parashikon se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

6. Në interpretim të nenit 4, pika 2, të ligjit për ndihmën shtetërore, masa përbën ndihmë shtetërore nëse autoritetet shtetërore ofrojnë pasuri në pronësi të shtetit shqiptar për ndërmarrjet/subjektet investuese strategjike dhe japin ndihmë shtetërore në formën e:



- a) grantit dhe subvencioneve;
- b) përjashtimin, uljen dhe diferencimin e taksave;
- c) faljen e pagesave të prapambetura dhe gjobave;
- d) faljen e borxheve ose mbulimin e humbjeve;
- e) garancitë mbi kreditë ose dhënien e kredive me norma interesi të ulta;
- f) uljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore;
- g) uljen e çmimit të produkteve të ofruara, ose shitjen e pronës shtetërore nën çmimin e tregut, ose blerjen e produkteve me çmim më të lartë se ai i tregut;
- h) zmadhimin e kapitalit shtetëror tek ndërmarrjet ose ndryshim të vlerës së tij në rrethana të cilat nuk janë të pranueshme për një investitor privat që vepron në kushte ekonomike normale.

7. Njëpërmjet zbatimit të ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, nëse autoritetet shtetërore vënë në dispozicion trojet, pyjet, tokat bujqësore, si dhe pasuritë e tjera të paluajtshme, në pronësi të shtetit shqiptar me kushte dhe kritere të favorshme kundrejt normave të tregut të vlefshme për subjekte investuese strategjike<sup>1</sup>, në ndonjërin prej formave që parashikohen në pikën 2, të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, atëherë masa mund të përbëjë ndihmë shtetërore.

8. Autoritetet shtetërore duhet të vlerësojnë nëse japin ndihmë shtetërore në momentin e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, të rregulluara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

9. Legjislacioni evropian për ndihmën shtetërore përcakton 2 metoda për përjashtimin e mundësisë së ekzistencës së elementëve të ndihmës

shtetërore<sup>2</sup>:

Së pari, shitjen e tokës dhe pronave shtetërore mbi bazën e një procedure të ofertave të publikuara, të hapura dhe pa kushte, në krahasim me përdorimin e procedurës së ankandit, duke pranuar ofertën më të mirë apo të vetme, dhe

Së dyti, një vlerësim *ex-ante* i raportit të vlerësimit i përgatitur nga një ekspert i pavarur.

Këto metoda kërkojnë të sigurojnë që çmimi me të cilin prona është ofruar në dispozicion të projekteve investuese strategjike nga një autoritet publik të reflektojë në mënyrë të drejtë, sa më shumë të jetë e mundur, vlerën e tregut të pronës së ofruar. Në këtë mënyrë do të përjashtohet mundësia që vënia në dispozicion e pronës publike t'i japë një avantazh ekonomik investitorit të investimit strategjik. Megjithatë nuk përjashtohet mundësia e përdorimit të metodave të tjera të vlerësimit për të vërtetuar nëse çmimi realisht i paguar nga investitori pasqyron, për aq sa është e mundur, vlerën e tregut të pronës publike<sup>3</sup>.

10. Për sa më lart, Komisioni i Ndhmës Shtetërore e konsideron skemën e ndihmës shtetërore të krijuar njëpërmjet hartimit të projektligjit “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me nenin 13, shkronja "a" të ligjit nr.9374 datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13, shkronja "a", 17, shkronja "ç", 22, pika 2, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. Në zbatim të nenit 27, pika 2 e ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin e Këshillit të Ministrave të përcaktohet se “për çdo rast të vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, të merret miratimi paraprak nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore”.

<sup>1</sup> Ligji nr. 55, datë 28.05.2015 neni 3, pika 17 përkufizon se “*Subjekte investuese strategjike*” janë subjektet investuese të interesuara për zhvillimin dhe realizimin e një investimi të kualifikuar si strategjik, sipas këtij ligji. Subjekte investuese strategjike mund të jenë personat juridikë privatë, vendas dhe të huaj.

<sup>2</sup> OJ C 209, 10.7.1997, p. 3

<sup>3</sup> Vendimi i Komisionit Evropian 30/01/ 2008 State Aid C 35/06 (ex NN 37/06)



2. Në zbatim të nenit 31, pika 2 e ligjit nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin e Këshillit të Ministrave të përcaktohet se “për funksionimin dhe administrimin e Fondit të Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike do të të merren parasysh të gjitha format e ndihmave që ndërmarrjet/ subjekte investuese strategjike kanë përfituar apo mund të përfitojnë nga burime të tjera shtetërore”.

3. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në rolin e “dritares unike”, në

kuadër të zbatimit të detyrave funksionale e të ofrimit të shërbimeve për investitorin, të përcaktuara në ligjin për investimet strategjike, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë informacion për zbatimin e nenit 27 dhe 31 e ligjit, nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” për vitin paraardhës financiar.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Arben Ahmetaj**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë